



V E N D I M

Nr.340, datë 6. 6. 2018

P Ë R

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E ZGJEDHJES SË PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së 15 përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës.
2. Përfaqësuesit e diasporës, kandidatë për anëtarë në Këshillin Koordinues të Diasporës, përveç kriterëve të parashikuara në ligjin nr.16/2018, “Për diasporën”, duhet të përmbushin edhe këto kriterë:
 - a) Të jenë persona të spikatur në fushat e arsimit, shkencës, teknologjisë, kulturës, sportit etj., apo të suksesshëm në fushën e biznesit;
 - b) Të jenë persona të njohur në fushën e filantropisë dhe të kenë kontribuar në çështje që lidhen me diasporën apo vendin e origjinës;
 - c) Të jenë pjesë aktive e forumeve organizative të diasporës në vendet pritëse.
3. Për procedurën e propozimit e të zgjedhjes duhet të zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
4. Numri i kandidaturave duhet të jetë jo më pak se dyfishi i numrit të përfaqësimit, duke iu referuar rendit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 20, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”.



5. Ambasadorët e jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë të Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për punët e jashtme i propozojnë ministrit përgjegjës për diasporën kandidatët për Këshillin Koordinues të Diasporës.
6. Ambasadorët bashkëpunojnë me organizatat e diasporës, të njohura e të regjistruara sipas legjislacionit të vendit pritës, për gjetjen e kandidaturave.
7. Për raste të veçanta ose në mungesë të kandidaturave të propozuara, propozimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës (jo më shumë se 3 propozime) mund të bëhet drejtpërdrejt nga ministri përgjegjës për diasporën.
8. Propozimet duhet të shoqërohen me jetëshkrime e dokumente, kualifikime dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së përfaqësuesit të propozuar.
9. Në vijim të propozimeve të ardhura, ministri përgjegjës për diasporën përzgjedh 15 kandidatët për anëtarë të Këshillit Koordinues të Diasporës, dhe ia përcjell për miratim Këshillit të Ministrave.
10. Të paktën 30 për qind e anëtarësisë duhet të jetë e përfaqësuar nga gjinia femërore.
11. Përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Diasporës zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë.
12. Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës lirohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen, me kërkesë individuale;
 - b) ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit;
 - c) lirohet për shkaqe të tjera.
13. Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës shkarkohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:
 - a) neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e këshillit drejtues;
 - b) nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji nr.16/2018, “Për diasporën”, dhe nga ky vendim;
 - c) nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhje për më shumë se 2 herë radhazi;



- ç) bëhet i paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore;
- d) gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, vepron në kundërshtim me interesat e Këshillit Koordinues të Diasporës.

14. Ministri përgjegjës për diasporën, jo më vonë se 30 ditë pune para mbledhjes së ardhshme të Këshillit Koordinues të Diasporës, i propozon Këshillit të Ministrave kandidatët e rinj, për të zëvendësuar anëtarin e liruar apo të shkarkuar. Mandati i zëvendësuesit llogaritet i plotë, nga dita e emërimit të tij.

15. Përjashtimisht për zgjedhjet e para, propozimet duhet të dorëzohen para fundit të muajit gusht 2018.

16. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA